L I G J
Nr.7938 datë, 24.5.1995

“PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1074, DATË 21.4.1995 “PËR SHPËRBËRJEN E POLICISË FINANCIARE DHE KRIJIMIN E POLICISË DOGANORE DHE POLICISË TATIMORE”

Në mbështetje të nenit 16 dhe 28, të ligjit nr.7491 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet dekreti nr.1074, datë 21.4.1995 “Për shpërbërjen e Policisë Financiare dhe krijimin e Policisë Doganore dhe Policisë Tatimore” me ndryshimet si më poshtë:

Në nenin 2, paragrafi i dytë formulohet:

“Organet e Policisë Doganore varen nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Drejtuesi i saj emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Financave”

Në nenin 3, paragrafi i dytë, të formulohet:

“Organet e Policisë Tatimore varen nga Drejtori i Tatimeve në Ministrinë e Financave. Drejtuesi i saj emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Financave”

Neni 4, formulohet: “Struktura organizative e Policisë Doganore përbëhet nga oficerë dhe nënoficerë në vartësi të drejtorit të përgjithshëm të Doganave”

Në nenin 5, pas pikës 5, shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“Siguron mbrojtjen e punonjësve të organeve tatimore gjatë kryerjes së detyrës së tyre”

Neni 8, formulohet:

“Struktura organizative e Policisë Tatimore përbëhet nga oficerë dhe nënoficerë në vartësi të drejtorit të tatimeve në Ministrinë e Financave”.

Në nenin 9, pas pikës me numër rendor 5, vihet numri “6”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1118, datë 2.6.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha